

K O N V E N T E

MIDIS REPUBLIKES POPULLORE TE SHQIPERISE DHE REPUBLIKES DEMOKRATIKE GJERMANE MBI DHENJEN E NDIHMES JURIDIKE PER ÇESHTJE CIVILE, FAMILJARE DHE PENALE

Presidiumi i Kuvendit Popullor te Republikes Popullore te Shqiperise dhe Presidenti i Republikes Demokratike Gjermane duke dashur ti forcojne marredheniet miqesore midis te dy vendeve dhe popujve te tyre, po ashtu edhe politiken e ndertimit pagesor dhe te forcimit te pages boterore edhe ne fushen e bashkepunimit juridik, vendosen te lidhin nje konvente mbi dhenien e ndihmes juridike ne çeshtjet civile, familjare dhe penale.

Per kete qellim emeruan te plotfugishmit e tyre:

Presidiumi i Kuvendit Popullor te Republikes Popullore te Shqiperise, Ministrin e Puneve te Jashteme te Republikes Popullore te Shqiperise Behar Shtylla.

Presidenti i Republikes Demokratike Gjermane ngarkon Zevende Ministrin e Puneve te Jashteme Oto Vincer.

te cilet pas shkembimit te plotfugishmerive te tyre, qe u gjeten ne formen e duhur dhe te plote u muarren vesh per sa vijon:

PJESA E PARE DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Neni l.

Mbrojtja juridike

1/ Shtetasit e njeres Pale Kontraktonjese, per sa u perket te drejtave te tyre personale dhe pasurore, gezojne ne territorin e Pales tjeter Kontraktonjese po ate mbrojtje juridike sikunder edhe shtetasit e kesaj Pale Kontraktonjese.

Kjo vlen edhe per personat juridike, qe jane krijuar ne perputhje me legjispcionin e njeres nga Palet Kontraktonjese.

2/ Ata kane te drejte te drejtohen lirisht dhe pa pengesane organet e Pales tjeter Kontraktonjese, ne kompetencen e te cileve hyjne çeshtjet civile, familjare dhe penale; ata mund te

marrin pjese ne keto organe dhe t'u drejtojne kerkesa dhe te ngrejne padi po ne ato kushte si dhe shtetasit e Pales tjeter Kontraktonjese.

Neni 2.

Vellimi i ndihmes juridike

Palet Kontraktonjese i japin njera tjetres ndihme juridike me ane te kryerjes se veprimeve te vecanta proceduriale, ne vecanesi me ane te perpilimit dhe dergimit te akteve dhe dokumentave, te kryerjes se kontrollimeve dhe kqyerjeve, dergimit dhe dorezimit te provave materiale, te pyetjes se te pandehurve, desmitareve dhe ekspertereve, te pyetjes se paleve dhe te personave te tjere, te kqyrjes gjyquesore, si dhe me anen e plotesimit te porosise per dorezimin e dokumentave.

Neni 3.

Dhenia e ndihmes juridike

1/ Gjykatat, organet e prokurorise dhe te noterise shteterore te te dy Paleve Kontraktonjese i japin ndihme juridike njeri tjetrit per qeshtje civile, familjare dhe penale.

2/ Organet qe permenden ne piken 1 u japin ndihme juridike edhe organeve te tjera, ne kompetencen e te cileve hyjne qeshtjet civile, familjare dhe penale.

Neni 4.

Menyra e komunikimit

Ne dhenien e ndihmes juridike organet e Paleve Kontraktonjese te permendura ne piken 1 te nenit 3 komunikojne me njeri tjetrin nepermjet organeve qendrore te drejtesise dhe prokurorise, perveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga kjo konvente.

Neni 5.

Forma e porosise ne dhenien e ndihmes juridike

Kerkesa per dhenien e ndihmes juridike duhet te permbaje keto te dhena:

- a) emertimin e organit qe ben porosine;

./. .

- b) emertimin e organit qe i drejtohet porosia;
- c) emertimin e çeshtjes per te cilen kerkohet ndihme juridike
- ç) emrin dhe mbiemrin e paleve, te te pandehurve ose te te denuarve, shtetesine e tyre, profesionin, vendbanimin ose ne raste te vecanta vendqendrimin;
- d) emrat dhe mbiemrat dhe adresat e perfaquesuesve te tyre;
- dh) te dhenat e nevojshme mbi thelbin e porosise per çesh-tje penale, pershkrimin e figures se krimit.

Neni 6.

Menyra e kryerjes se porosise

1/ Gjate kryerjes se porosise per dhenien e ndihmes juridike, organi, te cilit i eshte drejtuar porosia, zbaton legjisla-cionin e shtetit te tij. Por, me kerkesen e organit qe ben porosi-ne ai mund te zbatoje normat proceduriale te Pales Kontraktonjese qe ben porosine, ne qofte se ato nuk jane ne kundershtim me legjis-lacionin e Pales Kontraktonjese se ciles i eshte drejtuar kerkesa.

2/ Ne qofte se organi, te cilit i drejtohet porosia, nuk eshte kompetent per kryerjen e saj, atehere ai porosine ia dergon organit kompetent dhe njofton organin qe ka bere kerkesen.

3/ Me kerkesen e organit, i cili ka bere porosine, organi te cilit i eshte drejtuar porosia njofton me kohe ate se kur dhe ku do te kryhet porosia per dhenien e ndihmes juridike.

4/ Pas kryerjes se porosise per dhenien e ndihmes juridike, organi, te cilit i eshte drejtuar kerkesa, ia kthen dokumen-tat organit qe ka bere porosine; ne ato raste kur ndihma juridike nuk ka qene e mundur te jepet, ai tregon njekohesisht edhe rrretha-nat qe pengojne kryerjen e porosise.

Neni 7.

Paprekshmeria e deshmitareve dhe eksperteve

1/ Deshmitari ose eksperti qe paraqitet ne organet e Pales Kontraktonjese, e cila ka bere porosine me ftese te dore-zuar atij nga organi i Pales Kontraktonjese, qe i eshte drejtuar

porosia, pamvaresisht nga shtetesia e tij, nuk mund t'i nene-shtrohet ndjekjes ose arrestimit, qofte per vepra penalisht te denueshme, qe perbejne objektin ne shqyrtim, qofte per ndonje veper tjeter, qe denohet penalisht, te kryer para se te kalonte kufirin e shtetit qe ka bere porosine. Ay nuk mund te denohet gjithashtu per vepra te tilla ne territorin e Pales Kontraktonje-se qe ka bere porosine.

2/ Deshmintari ose eksperti e humbet kete privilegj ne qofte se, me gjith mundesine qe ka nuk e le territorin e Pales Kontraktonjese qe ka bere porosine brenda nje jave nga dita kur organi qe ka bere porosine e njofton ate se perdonimi i metej-shem i tij s'eshte i nevojshem.

Ne kete afat nuk llogaritet koha gjate se ciles deshmi-tari ose eksperti, jo per faj te tij, nuk ka mundur te lere teri-torin e Pales Kontraktonjese, qe ka bere porosine.

Neni 8.

Forma e dokumentave

Dokumentat qe dergohen ne baze te kesaj Konvente, duhet te kene vulen.

Neni 9.

Porosia per dorezimin e dokumentave

1/ Organi, te cilil i drejtohet porosia, dorezon doku-mentat ne perputhje me rregullat qe jane ne fuqi ne vendin e tij, ne qofte se dokumenti qe dorezohet eshte perpiluar ne gjuhen e organit qe ka bere porosine ose atij i eshte bashkangjitur perk-thimi i vertetuar. Ne raste te tjera, organi, qe i drejtohet po-rosia, i a dorezon kete dokument marresit, kur ky i fundit e pranon ate vullnetarisht.

2/ Vertetimin e perkthimit e ben perkthyesi zyrtar ose organi qe ka bere porosine, ose perfaquesuesi dipllomatik ose kon-sullor i njerës nga palet Kontraktonjese.

3/ Ne porosine per dorezimin e dokumentave duhet te she-nohen adresa e perpikte e marresit dhe emertimi i dokumentave, qe duhet te dorezohen.

4/ Kur dokumentat nuk mund te dorezohen ne adresen qe tregohet ne porosine, organi te cilit i drejtohet porosia, me iniciativen e tij, duhet te marre masat e nevojshme per te gjetur adresen. Kur gjetja e adreses nga organi, te cilit i eshte drejtuar porosia, eshte e pa mundur, ai njofton per kete organin qe ka bere porosine dhe i kthen ketij dokumentat qe duhej te dorezoheshin.

Neni 10.

Vertetimi i dorezimit te dokumentave

Vertetimi i dorezimit te dokumentave behet ne perputhje me dispozitat mbi dorezimin e dokumentave te Pales Kontraktonjese se ciles i drejtohet porosia.

Neni 11.

Dorezimi i dokumentave shtetasve te vet

1/ Palet Kontraktonjese kane te drejte t'u dorezojne dokumentat shtetasve te tyre nepermjet perfaqesive te tyre diplommatike ose konsullore.

2/ Ne raste te tilla dorezimi nuk mund te perdoren masa detyronjese.

Neni 12.

Njohja e dokumentave

1/ Dokumentat e perpiluara ose te vertetuara ne formen perkatese nga organi kompetent shteteror, ose nga personi zyrtar dhe te paisura me vule me steme ne territorin e njeres nga Palet Kontraktonjese, nuk kerkojne ndonje legalizim ne territorin e Pales tjeter Kontraktonjese. Po keshtu veprohet edhe per neneshkrimet e vertetuara simbas dispozitave te njeres nga Palet Kontraktonjese.

2/ Dokumentat, te cilet ne territorin e njeres nga Palet Kontraktonjese quhen si dokumenta zyrtare, kane fuqine provuese te dokumentave zyrtare edhe ne territorin e Pales tjeter Kontraktonjese.

Neni 13.

Shpenzimet lidhur me dhenien e ndihmes juridike

1/ Per dhenien e ndihmes juridike, Pala Kontraktonjese, se

.../...

ciles i eshte drejtuar porosia, nuk kerkon pagimin e shpenzimeve. Palet Kontraktonjese marin persiper te gjitha shpenzimet lidhur me dhenien e ndihmes juridike ne teritoret e tyre, si dhe shpenzimet lidhur me marjen e vertetimeve.

2/ Organi, te cilit i eshte drejtuar porosia, i njofton organit qe ka bere porosine shumen e shpenzimeve. Ne qofte se organi qe ka bere porosine do te mare keto shpenzime nga personi qe detyrohet t'i paguaje ato, keto i mbeten Pales Kontraktonjese qe i ka kerkuar.

Neni 14.

Refuzimi i dhenies se ndihmes juridike

Ndihma juridike mund te refuzohet kur dhenia e saj mund te demtoje sovranitetin ose sigurimin e Pales Kontraktonjese se ciles i eshte drejtuar porosia.

Neni 15.

Njoftime mbi çeshtjet juridike

Ministrat e drejtësise te Paleve Kontraktonjese i japin njeri tjetrit njoftime mbi çeshtjet juridike.

Neni 16.

Gjuhet

1/ Organet e Paleve Kontraktonjese ne komunikimet midis tyre lidhur me dhenien e ndihmes juridike perdon gjuhen e tyre ose gjuhen ruse.

2/ Perkthimet ne gjuhen e Pales Kontraktonjese ose ne gjuhen ruse se ciles i eshte drejtuar kerkesa, me qellim lehtesimi te komunikimeve lidhur me dhenien e ndihmes juridike, bashkangjiten mundesisht edhe ne ato raste kur nje gje e tille nuk kerkohet detyrimishte nga kjo Konvente.

PJESA E DYTE

PJESA E POSAQME

KAPITULLI I-re

Ndihma juridike ne çeshtjet civile dhe familjare

a) Shpenzimet gjyqesore

Neni 17.

Shtetasve te nje Pale Kontraktonjese, qe marrin pjese ne gjykatat e Pales tjeter Kontraktonjese dhe ndodhen ne teritorin e njeres nga Palet Kontraktonjese, nuk mund tu ngarkohet detyrimi per te siguruar shpenzimet gjyqesore vetem per shkak se ata jane te huaj, ose nuk kane vend banimi te perhereshem, ose vendqendrimi te perhereshem.

Neni 18.

Shtetasit e njeres Pale Kontraktonjese perjashtohen nga shpenzimet gjyqesore ne teritorin e Pales tjeter Kontraktonjese po ne ato kushte dhe po ne ate mase sikunder edhe vete shtetasit e tyre.

Neni 19.

1/ Dokumentat mbi gjendjen personale si dhe familjare, mbi t'ardhurat dhe pasurine, qe nevojiten per t'u perjashtuar nga pagimi i shpenzimeve gjyqesore, leshohen nga organet kompetente te Pales Kontraktonjese, ne teritorin e se ciles personi i interesuar ka vendbanimin ose vend qendrimin e tij.

2/ Ne qofte se personi i interesuar nuk ka vend banimi ose vend qendrimi, ne asnje nga teritoret e Paleve Kontraktonjese, eshte i mjaftueshem dokumenti qe leshohet ose legalizohet nga perfaqesia diplomatike ose konsullore e shtetit te tij.

3/ Gjykata qe ka dhene vendimin ne baze te kerkeses te interesuarit mbi perjashtimin nga pagimi i shpenzimeve gjyqesore, mund t'i kerkoje shpjegime plotesonjese organit qe i leshoj dokumentin.

Neni 20.

1/ Shtetasi i njeres Pale Kontraktonjese, qe desheron ti beje kerkese Gjykates se Pales tjeter Kontraktonjese mbi perjashtimin nga pagesa e shpenzimeve gjyqesore, si dhe mbi pjese-marrjen e avokatit ne zhvillimin e procesit, mund t'ia parashtroje me goje kete kerkese Gjykates kompetente ne vend banimin ose

vend qendrimin e tij, e cila kete kerkese e shenon ne proces verbal dhe kete se bashku me dokumentin qe permendet ne paragrafin I neni 19, si dhe dokumentat e tjera te paraqitura nga personi i interesuar ja percjell Gjykates kompetente te Pales tjeter Kontraktonjese.

2/ Njikohesish me kerkesen mbi perjashtimin nga pagesa e shpenzimeve gjyquesore, ne proces verbal mund te behet edhe shenimi i nje kerkesa tjeter per padi ose per procedim tjeter.

b) Personat dhe e drejta familjare

Neni 21.

Zotesia per te vepruar e nje personi percaktohet nga legjislacioni i Pales Kontraktonjese, shtetas i se ciles ai eshte.

Neni 22.

Forma e lidhjes se marteses

1/ Forma e lidhjes se marteses percaktohet nga legjislacioni i Pales Kontraktonjese, ne teritorin e seciles behet lidhja e marteses.

2/ Forma e lidhjes se marteses, qe zbatohet nga perfaqesonji dipllomatik ose konsullor i autorizuar, percaktohet nga legjislacioni i vendit te perfaqesise dipllomatike ose konsullore.

Neni 23.

Marredheniet juridike personale dhe pasurore te bashkeshorteve

1/ Marredheniet juridike personale dhe pasurore te bashkeshorteve, percaktohen nga legjislacioni i asaj Pale Kontraktonjese, shtetas te se ciles jane bashkeshortet.

2/ Kur njeri nga bashkeshortet eshte shtetas i njeres Pale Kontraktonjese dhe tjetri eshte shtetas i Pales tjeter Kontraktonjese, marredheniet e tyre juridike personale dhe pasurore percaktohen nga legjislacioni i asaj Pale Kontraktonjese, ne teritorin e se ciles ata kane ose kane patur kohet e fundit vendbanimin e perbashket te tyre.

Neni 24.

Zgjidhja e marteses dhe deklarimi i saj si e pavlefeshme

1/ Per çeshtjet e zgjidhjes se marteses dhe deklarimit te saj si te pavlefeshme zbatohet legjislacioni dhe ne parim kompetent jane gjykatat e asaj Pale Kontraktonjese, shtetas te se ciles kane qene bashkeshortet ne kohen e ngritjes se padise. Kur bashkeshortet kane vendbanimin ne teritorin e Pales tjeter Kontraktonjese, kompetente jane gjithashtu edhe gjykatat e kesaj Pale Kontraktonjese.

2/ Kur ne kohen e ngritjes se padise mbi zgjidhjen e marteses ose per deklarimin e saj si te pa vlefeshme njeri nga bashkeshortet eshte shtetas i njeres Pale Kontraktonjese dhe tjetri shtetas i Pales tjeter Kontraktonjese dhe njeri banon ne territorin e njeres dhe tjetri ne teritorin e tjetres Pale Kontraktonjese, per çeshtjet e zgjidhjes se marteses dhe deklarimit te saj si te pavlefeshme kompetente jane gjykatat e te dy Paleve Kontraktonjese. Ne kete rast Gjykatat zbatojne legjislacionin e vendit te tyre.

Neni 25.

Deklarimi i çdukjes, i vdekjes dhe konstatimi i faktit te vdekjes

1/ Per çeshtjet e deklarimit te vdekjes (njohja e çdukjes dhe deklarimi i vdekjes) ose te konstatimit te kohes se vdekjes (konstatimi i faktit te vdekjes) kompetente jane organet e asaj Pale Kontraktonjese shtetas i se ciles ka qene personi n'ate kohe kur ishte i gjalle sipas te dhenave te fundit.

2/ Organet e njeres Pale Kontraktonjese mund te shpallin shtetasin e Pales tjeter Kontraktonjese te vdekur (te njohin te çdukur ose te vdekur) si edhe te konstatojne kohen e vdekjes (te konstatojne faktin e vdekjes se tij) simbas kerkeses se personave qe banojne ne territorin e saj, kur te drejtat dhe interesat e tyre bazohen ne legjislacionin e kesaj Pale Kontraktonjese.

3/ Ne rastet e parashikuara ne paragrafet 1 dhe 2 organet e Paleve Kontraktonjese zbatojne legjislacionin e shtetit te tyre.

Marredheniet juridike midis prinderve dhe femijeve

Neni 26.

Geshtjet mbi kundershtimin dhe vertetimin e atesise si dhe mbi percaktimin e lindjes se femijve nga nje martese e dhene, zgjidhen ne perputhje me legjislacionin e Pales Kontraktonjese, shtetas i se ciles eshte femija me lindjen e saj.

Neni 27.

Marredheniet juridike midis femijes qe ka lindur nga personat qe nuk kane lidhur martese dhe nenes se tij nga njera ane dhe atit te tij nga ana tjeter, percaktohen nga legjislacioni i Pales Kontraktonjese, shtetas i se ciles eshte femija.

Neni 28.

1/ Per marjen e vendimeve lidhur me marredheniet juridike te permendura ne nenet 26 dhe 27 kompetente jane gjykatat e asaj Pale Kontraktonjese, ligjet e se ciles duhet te zbatchen ne keto raste.

2/ Kur paditesi dhe i padituri banojne ne territorin e njerëz nga Palet Kontraktonjese, atehere kompetente jane edhe gjykatat e kesaj Pale Kontraktonjese, por duke respektuar dispozitat e neneve 26 dhe 27.

Kujdestaria dhe tutoria

Neni 29.

1/ Per çeshtjetbe kujdestarise dhe tutorise ndaj shtetasve te Paleve Kontraktonjese, kur Konventa nuk parashikon ndryshe, kompetent eshte organi i kujdestarise se Pales Kontraktonjese shtetas i se ciles eshte personi i vene nen kujdestari ose nen tutori.

2/ Marredheniet juridike midis kujdestarit ose tutorit dhe personit qe gjendet nen kujdestari ose tutori, percaktohen nga legjislacioni i Pales Kontraktonjese, organi i kujdestarise te se ciles ka caktuar kujdetarin ose tutorin.

Neni 30.

1/ Kur marrjen e masave ne lidhje me tutorene ose kujdestarine e kerkojne interesat e personit te vene nen tutori ose nen kujdestari, vendbanimi ose vend qendrimi, ose pasuria e te cilite

qe ndodhet ne territorin e Pales tjeter Kontraktonjese, organi i kujdestarise i kesaj Pale kontraktonjese duhet tianjoftoje menjehere organit te kujdestarise te Pales tjeter Kontraktonjese, qe eshte kompetent ne baze te paragrafit 1 te nenit 29.

2/ Ne raste te nguteshme, organi i kujdestarise i Pales tjeter Kontraktonjese mund te marre edhe vete masa te nevojshme, por ai duhet te njoftoje me njihere mbi masat paraprake qe ka marre organin e kujdestarise qe eshte kompetent ne baze te paragrafit 1 neni 29. Masat e Mara mbeten ne fuqi gjer sa ky organ i kujdestarise te mare ndonje vendim tjeter.

Neni 31.

1/ Kur vendbanimi ose vendqendrimi, ose pasuria e personit qe eshte nen tutori ose kujdestari ndodhet ne territorin e Pales tjeter Kontraktonjese, organi i kujdestarise, i cili eshte kompetent ne baze te paragrafit 1 neni 29 mund t'ua kaloje tutorine ose kujdestarine organeve te Pales tjeter Kontraktonjese. Kalimi eshte i vlefshem vetem n'ate rast kur organi i kujdestarise te cilit i behet kerkeze pranon detyren e tutorise ose kujdestarise dhe per kete njofton organin e kujdestarise qe ka bere kerkeze.

2/ Organji i kujdestarise i Pales tjeter Kontraktonjese, qe eshte kompetent sipas paragrafit 1, zbaton kujdestarine dhe tutorine ne perputhje me legjislacionin e shtetit te tij. Por ai duhet te zbatuje legjislacionin e Pales Kontraktonjese, shtetas i se ciles eshte personi i vene nen tutori ose kujdestari persa i perket zotesise per te vepruar te personit te vene nen tutori ose kujdestari. Ai nuk ka te drejte te jape vendime per çeshtje qe kane te bejne me gjendjen (status) personale te personit qe eshte nen tutori ose kujdestarin, por mund te jape leje per lidhje martese kur kjo eshte e nevojeshme simbas ligjes se Pales Kontraktonjese, shtetas i se ciles eshte personi qe eshte nen tutori ose kujdestari.

Neni 32.

A d o p t i m i

1/ Adoptimi ose pushimi i tij rregullohet nga legjislacioni i Pales Kontraktonjese, shtetas i se ciles eshte adoptuesi ne kohen e adoptimit ose te pushimit te adoptimit.

.//..

2/ Kur femija eshte shtetas i pales tjeter Kontraktonjese, per adoptimin ose pushimin e adoptimit duhet te meret pelqimi i femijes, ne qofte se kjo kerkohet nga ligja e vendit te shtetit te tij, te perfaqesonjesit ligjor te tij dhe te organit shteteror kompetent te kesaj Pale Kontraktonjese.

3/ Kur femija adoptohet nga bashkeshorte, njeri prej te cileve eshte shtetas i njeres nga Palet Kontraktonjese dhe tjetri shtetas i Pales tjeter Kontraktonjese, adoptimi ose pushimi i tij behet ne perputhje me legjispcionin ne fuqi ne teritorët e te dy Paleve Kontraktonjese.

4/ Per çeshtjet e adoptimit ose te pushimit te tij kompetente jane organet e Pales Kontraktonjese, shtetas i se ciles eshte adoptuesi ne çastin e adoptimit ose te pushimit te tij. Per rastin e parashikuar ne piken 3 kompetent eshte organi ne rrëthim e veprimtarise te te cilit bashkeshortet kane ose kane patur ne kohen e fundit vendbanimin ose vendqendrimin e tyre te perbashket.

Neni 33.

Dergimi i vertetimeve mbi gjendjen civile dhe te dokumentave te tjera

Palet Kontraktonjese detyrohen qe me kerkesa ti dergojne falas njera tjetres nepermjet te organeve qendrore te tyre kompetente vertetimet mbi gjendjen civile dhe dokumentat e tjera, qe kane te bejne me te drejtat dhe interesat personale te shtetasve te Pales Kontraktonjese.

c) Dispozitat mbi çeshtjet e trashegimise

Neni 34.

Parimi i barazise se te drejtave

1/ Shtetasit e njeres Pale Kontraktonjese barazohen ne te drejtat me shtetasit e Pales tjeter Kontraktonjese, qe banojne ne teritorin e saj persa i perket zotesise per te bere dhe revokuar testamente per pasurine qe gjendet ne teritorin e Pales tjeter Kontraktonjese, ose per te drejta qe duhet te ushtrohen atje, sidhe persa i perket zotesise per te fituar me trashigim pasurin ose te drejta. Pasuria ose te drejtat kalojne tek ata po ne ato kushte qe

./. .

jane caktuar per shtetasit e Pales Kontraktonjese, qe banojne ne teritorin e saj.

2/ Dokumentat qe vertetojne te drejten e trashegimise jane deshmia mbi trashegimine ose vertetimi mbi ekzekutimin e testamentit te perpiluar nga organi kompetent i nieres Pale Kontraktonjese, shembjne gjithashtu si vertetim i fakteve perkatese edhe ne teritorin e Pales tjeter Kontraktonjese.

Neni 35.

E drejta e trashegimise

1/ E drejta e trashegimise mbi pasurine e luejteshme rregullohet nga legjislacioni i asaj Pale Kontraktonjese, shtetas i se ciles ka qene trashegimlenesi ne kohen e vdekjes se tij.

2/ E drejta e trashegimise mbi pasurine e palujteshme rregullohet nga legjislacioni i asaj Pale Kontraktonjese, ne teritorin e se ciles ndodhet pasuria.

Neni 36.

T e s t a m e n t i

1/ Zotesia per te bere ose revokuar testament si dhe paso-jat juridike te te metave ne çfaqjen e vullnetit percaktohen nga legjislacioni i Pales Kontraktonjese, shtetas i se ciles ka qene trashegimlenesi ne kohen e çfaqjes se vullnetit. Po nga ky legjis-lacion percaktohen edhe llojet e testamenteve qe lejohen.

2/ Format e testamenteve percaktohen nga legjislacioni i Pales Kontraktonjese, shtetas i se ciles trashegimlenesi ka qene ne kohen qe eshte bere testamenti. Me gjithate, mjafton edhe te jetë respektuar legjislacioni i Pales Kontraktonjese, ne teritorin e se ciles ishte bere testamenti.

Kjo dispozite ka fuqi edhe persa i perket revokimit te testamentit.

Neni 37.

Kompetenca ne çeshtjet e trashegimit

1/ Çeshtjet ne lidhje me trashegimin e pasurise se lujtesh-me, me perjashtim te rastit te parashikuar ne piken 4, shqyrtohen nga organet e Pales Kontraktonjese, shtetas i se ciles ka qene trashegimlenesi ne kohen e vdekjes.

2/ Çeshtjet ne lidhje me trashegimin e pasurise se palujteshme shqyrtohen nga organet e Pales Kontraktonjese, ne territorin e se ciles ndodhet kjo pasuri.

3/ Dispozitat e pikes 1 dhe 2 zbatohen perkatesisht edhe per konfliktet qe lindin ne baze te se drejtes se trashegimise.

4/ Kur e gjithe pasuria e lujteshme e trasheguar, qe mbetet mbas vdekjes se shtetasit te njeres nga Palet Kontraktonjese, ndodhet ne territorin e Pales tjeter Kontraktonjese dhe jane dakord te gjithe trashegimtaret, atehere me kerkesen e trashegimtarit ose te personit ne dobi te te cilite eshte lene legu, procedimi per çeshtjen ne lidhje me trashegimin behet nga organet e kesaj Pale Kontraktonjese.

Neni 38.

Njoftimi per vdekjen

1/ Kur ne territorin e njeres Pale Kontraktonjese vdes shtetasi i Pales tjeter Kontraktonjese, organi lokal duhet te lajmeroje menjihere perfaqesine dipllomatike ose konsullore te Pales tjeter Kontraktonjese mbi rastin e vdekjes dhe te njoftoje gjithshka qe di per trashegimtaret, bendbanimin ose vendqendrimin e tyre, per masen dhe vleften e trashegimit si dhe ne se ka testament. Kjo dispozite zbatohet edhe n'ato raste kur organi kompetent i njeres nga Palet Kontraktonjese mer njoftim se shtetasi i Pales tjeter Kontraktonjese qe ka vdekur jashte territoreve te te dy Paleve Kontraktonjese, ka lene pasuri ne territorin e shtetit te tij.

2/ Ne qofte se perfaqesia dipllomatike ose konsullore do te marre vesh e para per vdekjen, ajo me qellim ruajtjeje te trashegimise duhet te njoftoje per kete organin kompetent qe meret me çeshtjet e trashegimise.

Neni 39.

Te drejtat e perfaqesive dipllomatike dhe konsullore
ne perfaqesimin e çeshtjeve trashegimore

1/ Ne te gjitha çeshtjet ne lidhje me trashegimine, qe lindin ne territorin e njeres nga Palet Kontraktonjese, perfaqesija dipllomatike ose konsullore ka te drejte te perfaqesoje para organeve te Pales Kontraktonjese interesat e shtetasve te shtetit

.//.

te vet, kur ata nuk marin pjese ne procedim dhe nuk kane caktuar perfaquesuesit e tyre; ne keto raste nuk kerkohet ndonje prokure e vecante.

2/ Kur shtetasi i njeres Pale Kontraktonjese vdes gjate udhetimit ne territorin e Pales tjeter Kontraktonjese, ku ai nuk ka patur vendqendrimin ose vendbanimin e perhereshem, sendet qe ai kish te me vehte i dorezohen perfaqesise dipllomatike ose konsullore pa ndonje formalitet.

Neni 40.

Gelja e testamentit

Testamenti çelet dhe shpallet nga organi kompetent, qe meret me çeshtjet e trashegimise te asaj Pale Kontraktonjese, ne territorin e se ciles ndodhet testamenti. Ne qofte se trashegimlenesi kabuanar ne territorin e Pales tjeter Kontraktonjese, atehere organit kompetent qe meret me çeshtjet e trashegimise i dergohet kopja e testamentit dhe proces verbal i mbi gjendjen dhe permbajtjen e tij dhe ne rast nevoje edhe mbi hapjen dhe shpalljen e testamentit; me kerkese te tij, i dergohet edhe origjinali i testamentit.

Neni 41.

Masat per ruajtjen e trashegimit

1/ Organet e njeres Pale Kontraktonjese qe meren me çesh-tjet e trashegimise jane te detyruar te marin ne perputhje me legjis-lacionin e tyre masat e nevojshme per ruajtjen ose administrimin e pasurise trashegimore ne shtetin e tyre, te lene nga shtetasi i Pales tjeter Kontraktonjese.

2/ Perfaqesia dipllomatike ose konsullore duhet te lajmero-het menjihere per masat e mara ne perputhje me piken 1; ajo mund te mare pjese direkt ose nepermjet te perfaquesuesit te saj ne zbatimin e ketyre masave. Masat e mara ne perputhje me piken 1 dhe masat e tjera te nevojshme, me kerkesen e perfaqesise dipllomatike ose kon-sullore, mund te ndryshohen, te revokohen ose te pezullohen.

3/ Me kerkesen e organit te shtetit te trashegimlenesit, qe meret me çeshtjet e trashegimise, masat e mara ne perputhje me piken 1 duhet te revokohen.

4/ Me kerkesen e perfaqesise dipllomatike ose konsullore kesaj i dorezohet pasuria e lujteshme dhe dokumentat e te vdekurit.

Neni 42.

Dorezimi i trashegimit

1/ Kur pasuria e lujteshme trashegimore ose shuma e nxjere nga shitja e pasurise se lujteshme ose te pa lujteshme pas perfundimit te procedimit trashegimor duhet tu dorezohet trashegimtareve qe ndodhen ne territorin e Pales tjeter Kontraktonjese, pasuria trashegimore ose shuma e nxjerre i dorezohen perfaqesise dipllomatike ose konsullore te ketij shteti.

2/ Organi qe meret me çeshtjet e trashegimise urdheron do rezimin e trashegimit perfaqesise dipllomatike ose konsullore ne keto raste:

a) Kur te gjitha kerkesat e kreditoreve te te vdekurit te paraqitura brenda afateve te caktuara nga legjislacioni i Pales Kontraktonjese jane paguar ose sigruar;

b) Kur te gjitha tatimet qe rrjedhin nga trashegimi jane paguar ose jane sigruar;

c) Kur organet kompetente kane dhene leje per nxjerrjen e pasurise trashegimore, ne qofte se nje leje e tille kerkohet.

Transferimi i shumave te te hollave behet ne perputhje me legjislacionin mbi valuten qe eshte ne fuqi ne teritoriet e Paleve Kontraktonjese.

ç) Njohja e vendimeve dhe ekzekutimi i detyrueshem.

Neni 43.

Njohja e vendimeve me karakter jo pasuror

Vendimet e gjykatave dhe organeve te tutorise dhe te kujdestarise te njeres Pale Kontraktonjese ne lidhje me çeshtjet me karakter jo pasuror, qe kane marre forme te prere, pranohen ne territorin e Pales tjeter Kontraktonjese pa shqyrtim te metejshem kur asnje Gjykate ose organ i tutorise dhe kujdestarise se Pales tjeter Kontraktonjese nuk ka dhene me pare ndonje vendim per kete çeshtje, i cili te kete marre forme te prere.

Kjo dispozite zbatohet edhe per vendimet e dhena para hyrjes ne fuqi te kesaj Konvente.

Neni 44.

Njohja e vendimeve me karakter pasuror

Vendimet e Gjykatave ne çeshtjet civile dhe familjare karakter pasuror te mara ne territorin e njerës Pale Kontraktor dhe qe kane marre forme te prere, njihen dhe ekzekutohen ne territorin e Pales tjeter Kontraktonjese kur keto vendime jane dhene hyrjes ne fuqi te kesaj Konvente.

Kjo dispozite zbatohet edhe per vendimet e dhena nga gjykatat, qe kane marre forme te prere dhe qe kane te bejne me shpenzmin e demit qe rrjedh nga çeshtje penale.

Ekzekutimi i vendimeve

Neni 45.

1/ Per ekzekutimin e detyrueshem te vendimeve te gjykatave njerës Pale Kontraktonjese, te cilet njihen ne baze te nenit ne territorin e Pales tjeter Kontraktonjese, me kerkesen perkat Gjykata kompetente e Pales tjeter Kontraktonjese jep lejen e ne shme.

Dokumentat qe kane shenimin per ekzekutim njihen si vendime te gjykatave.

2/ Dhenia e lejes per ekzekutim te detyrueshem dhe ekzekutimi i detyrueshem rregullohen nga legjislacioni i Pales Kontraktonjese, ne territorin e se ciles behet ekzekutimi.

Neni 46.

1/ Shqyrtimi i kerkesave per lejimin e ekzekutimit te detyrueshem hyn ne kompetencen e gjykatave te Pales Kontraktonjese ne territorin e se ciles duhet te behet ekzekutimi i detyrueshem

2/ Kerkesa per lejimin e ekzekutimit te detyrueshem i praqitet gjykates qe ka dhene ne shkalle te pare vendimin mbi çetjen, e cila pastaj i a dergon gjykates qe eshte kompetente per vendosur ne lidhje me kerkesen.

3/ Kerkeses i bashkangjitet perkthimi ne gjuhen e Pales Kontraktonjese, ose ruse, se ciles i drejtohet kerkesa; perkthimi vertetohet ne perputhje me pikën 2 nenit 9.

Neni 47.

1/ Kerkeses per lejimin e ekzekutimit te detyrueshem i bashkengjiten:

a) kopja zyrtare e vendimit me vertetimin qe ka marre forme te prere;

b) origjinalet ose kopjet e dokumentave te vertetuara, nga te cilat del se i padituri qe nuk mori pjese ne proces ka mare ne dorezim me kohe dhe ne formen e duhur lajmerimin ose ndonje njoftim tjeter zyrtar mbi ngritjen e padise;

c) perkthimet e vertetuara te kerkeses dhe dokumentave qe nuk permenden ne pikat "a" dhe "b".

2/ Njikohesisht me kerkesen mbi lejimin e ekzekutimit te detyrueshem mund te paraqitet kerkesa per kryerjen e ekzekutimit te detyrushem.

Neni 48.

Kundershtimi i te paditurit

Ne gjykate, ne te cilen shqyrtohet çeshtja mbi dhenien e lejes per ekzekutimin e detyrueshem i padituri mund te parashtroje kundershtimet e tij si per lejimin e ekzekutimit te detyrueshem, ashtu dhe per kerkesat e pranuara me vendimin qe duhet te ekzekutohet ne qofte se kundershtime te tilli lejohen nga legjislacioni i Pales Kontraktonjese, ne territorin e se ciles eshte dhene vendimi.

Neni 49.

Refuzimi i ekzekutimit te vendimeve gjyqesore

Lejimi i ekzekutimit te detyrueshem te vendimeve gjyqesore, perveç rasteve qe permenden ne nenin 14, mund te refuzohet:

a) Kur personi, qe paraqit kerkesen, ose i padituri nuk ka mare pjese ne gjykimin per shkak se atij, ose perfaqesonjesit te tij nuk i u dorezua me kohe dhe ne formen e duhur thirja per ne gjykate, ose per shkak se thirja i eshte bere vetem me ane shpalljeje publike, ose ne nje menyre tjeter qe nuk perputhet me dispozitat e kesaj Konvente;

b) kur vendimi i gjykates eshte ne kundershtim me nje vendim te mepareshem, qe ka marre forme te prere, te dhene per çesht-

jen midis po atyre paleve, po per ato shkaqe dhe po per ato objekte nga gjykata e Pales Kontraktonjese, ne territorin e se ciles duhet te kryhet ekzekutimi i detyrueshem.

Kjo dispozite nuk shtrihet ne ato raste kur kane ndryshuar ne menyre thelbesore rrethanat, ne baze te te cilave jane percak-tuar nga vendimi gjyqesor i meparshem permbajtja dhe koha e ekzekutimit.

Neni 50.

Ekzekutimi i vendimeve mbi pagimin e shpenzimeve
gjyqesore

1/ Kur pala ne çeshtje, e cila ne perputhje me nenin 17 eshte perjashtuar nga sigurimi i shpenzimeve gjyqesore me vendim, qe ka marre forme te prere, do te ngarkohet me pagimin e shpenzimeve gjyqesore dhe jo gjyqesore, gjykata kompetente e Pales tjeter Kontraktonjese me kerkese pa taksa lejon nxjerrjen e shpenzimeve ne favor te pales perkatese te rrjedhura nga ekzekutimi i detyrueshem i vendimit.

2/ Si vendime ne kuptimin e pikes 1 nenkuptohen gjithash-tu edhe vendimet mbi percaktimin e shpenzimeve.

Neni 51.

1/ Gjykata qe ka lejuar ekzekutimin e detyrueshem te ven-dimit mbi nxjerrjen e shpenzimeve gjyqesore kufizohet vetem ne kontrollin ne se vendimi ka marre forme te prere dhe ne se ay i shtrohet ekzekutimit.

2/ Kerkeses per te lejuar ekzekutimin e detyrueshem duhet ti bashkengjiten: kopja e vendimit mbi shpenzimet, e vertetuar nga Gjykata e shkalles se pare, shenimi i leshuar po nga kjo gjykate, se vendimi ka marre forme te prere dhe i shtrohet ekzekutimit, si dhe perkthimet e vertetuara te ketyre dokumentave.

3/ Shpenzimet e perkthimeve te permendura ne piken 2 nji-hen si nje pjese e shpenzimeve te rrjedhura nga ekzekutimi i detyru-eshem.

Neni 52.

1/ Ne pjesen qe i perket nxjerrjes se shpenzimeve gjyqeso-

./. .

re jo te paguara, gjykata e shkalles se pare e Pales Kontraktonjese, ne territorin e se ciles u paraqit kerkesa mbi pagimin e shpenzimeve, i drejtohet me kerkese gjykates kompetente te Pales tjeter Kontraktonjese per nxjerrjen e shpenzimeve gjyqesore. Kjo e fundit ngreçeshtjen mbi ekzekutimin e detyrueshem dhe i dergon shumen e nxjerre perfafesise dipplomatike ose konsullore te Pales tjeter Kontraktonjese.

2/ Kerkeses i bashkangjiten:

- a) llogaria e shpenzimeve;
- b) shenimi se vendimi ne baze te te cilil kryhet ekzekutimi, ka marre forme te prere.
- c) perkthimet e vertetuara te dokumentave qe permenden ne pikat "a" dhe "b".

3/ Shpenzimet lidhur me perkthimet e permendura ne piken 2 njihen si pjese e shpenzimeve qe rrjedhin nga ekzekutimi i detyrueshem.

Neni 53.

Dorezimi i sendeve

Ne rastin e ekzekutimit te detyrueshem dorezimi i sendeve shtetasve qe banojne ne territorin e Pales tjeter Kontraktonjese, behet ne perputhje me dispozitat qe jane ne fuqi brenda shtetit mbi eksportimin e sendeve ose mbi transferimin e shumave te te hollave.

Neni 54.

Shpenzimet qe rrjedhin nga ekzekutimi i detyrueshem

Persa i perket llogaritjes dhe nxjerrjes se shpenzimeve te rrjedhura nga ekzekutimi i detyrueshem zbatohet e njejta procedure si edhe ne rastin e ekzekutimit te vendimit te gjykatave te asaj Pale Kontraktonjese, ne territorin e se ciles ekzekutohet vendimi.

Neni 55.

Ekzekutimi i marreveshjeve te pajtimit

Dispozitat e neneve 44-49, 53 dhe 54 mbi vendimet gjyqesore zbatohen perkatesisht edhe per marreveshjet e pajtimit, te perfunduara ne gjykatat ose ne organet e tjera shteterore.

KAPITULLI II-te
NDIHMA JURIDIKE NE ÇESHTJET PENALE

Neni 56.

Dorezimi i fajtoreve

1/ Palet Kontraktonjese, ne perputhje me kete Konvente, ne baze te kerkeses, i dorezojne njera tjetres personat, kunder te cilive duhet te filloje ndjekja penale, ose duhet te ekzekutohet vendimi.

2/ Dorezimi behet vetem per ato vepra te cilat, ne perputhje me legjislacionin e te dy Paleve Kontraktonjese, jane te denuareshma dhe per kryerjen e te cilave ligja parashikon denim me heqje te lirise per me shume se nje vit, ose nje denim me te rende (qe me tutje do te quhen "krime qe shkaktojne dorezimin").

Neni 57.

Refuzimi i dorezimit

Dorezimi nuk mund te behet:

- a) kur personi, dorezimi i te cilit kerkohet, eshte shtetas i Pales Kontraktonjese, se ciles i eshte drejtuar kerkesa;
- b) kur krimi eshte kryer ne teritorin e Pales Kontraktonjese se ciles i eshte drejtuar kerkesa;
- c) kur ndjekja penale ose ekzekutimi i vendimit, ne baze te legjislacionit te Pales Kontraktonjese, se ciles i eshte drejtuar kerkesa, nuk lejohet per aresye te kalimit te afatit te parashkrimit, ose per aresye te dispozitave te tjera ligjore;
- ç) kur kundrejt personit, qe ka kryer krimin, eshte dhene vendim po per te njejtin krim ose eshte vendosur pushimi i çeshtjes nga gjykata ose nga organi tjeter i Pales Kontraktonjese, se ciles i eshte drejtuar kerkesa;
- d) kur krimi, ne perputhje me legjislacionin e te dy paleve Kontraktonjese, ndiqet ne baze te kerkeses se te demtuarit.

Neni 58.

Detyrimi per te filluar ndjekjen penale

1/ Secila Pale Kontraktonjese, me kerkesen e Pales tjeter Kontraktonjese, detyrohet te filloje, ne perputhje me legjislacionin e saj, ndjekjen penale kunder shtetasve te saj ne qofte se keta te

..../..

fundit kane kryer ne territorin e Pales tjeter Kontraktonjese krimi qe shkakton dorezimin.

2/ Kerkeses i bashkengjiten te gjitha provat qe disponohen per çeshtjen penale.

3/ Pala Kontraktonjese, se ciles i eshte drejtuar kerkesa, detyrohet te njoftuje Palen Kontraktonjese qe ka bere kerkesen mbi rezultatet e ndjekjes penale.

Kur per kete çeshtje eshte dhene vendim qe ka mare forme te prere, kopja e tij duhet t'i bashkengjitet lajmerimit.

Neni 59.

Menyra e komunikimit

Per çeshtjet e dorezimit te personave dhe fillimit te ndjekjes penale, meren vesh direkt brenda kompetencave te tyre, Ministri e drejtësise dhe Prokurorat e pergjitheshem te Paleve Kontraktonjese

Neni 60.

Kerkesa per dorezimin

1/ Kerkeses per dorezim duhet ti bashkengjiten:

a) persa i perket kerkeses per dorezimin me qellim ekzekimi te vendimit, kopja zyrtare e vendimit, me vertetimin se ka marre formen e prere;

b) persa u perket kerkesave te tjera, kopja e vertetuar e vendimit per arrestim dhe pershkrimi i krimit me shpjegimin e rrethanave te çeshtjes dhe tekstet e ligjeve, ne baze te te cileve cilesohet krimi. Ne qofte se krimi ka shkaktuar ose mund te shkaktonte dem material, ne kete pershkrim shenohen gjithashtu edhe perpjestimet e demit qe eshte shkaktuar ose mund te shkaktohej nga krimi.

2/ Kerkeses per dorezim duhet mundesisht ti bashkangjitet edhe pershkrimi i karakteristikave te jashteme te personit, dorezimi i te cilil kerkohet, te dhenat biografike mbi ate, shtetesi dhe vendrimi, si dhe fotografia dhe shenjat e gishterinjeve te tij.

3/ Pala Kontraktonjese qe drejton kerkesen, nuk eshte e detyruar ti bashkangjite kerkeses provat e fajit te personit, qe kerkohet te dorezohet.

Neni 61.

Informatat plotesuese per kerkesen e dorezimit.

1/ Kur informatat e dhena nuk jane te mjaftueshme per zgjidhjen e çeshtjes se dorezimit, Pala Kontraktonjese, se ciles i eshte dorezuar kerkesa, mund te kerkonte informata plotesuese. Per kete ajo mund ti caktoje Pales Kontraktonjese qe i ka paraqitur kerkesen nje afat i cili nuk duhet te kaloje dy muaj.

Me kerkesa perkatese ky afat mund te zgjatet.

2/ Kur Pala Kontraktonjese, qe ka paraqitur kerkesen, nuk paraqit informatat e nevojeshme plotesuese brenda afatit te caktuar, shteti te cilit i drejtohet kerkesa mund te liroje nga arrestimi personin qe kerkohet per dorezim.

Arestimi i personit qe duhet te dorezohet

Neni 62.

Me marrjen e kerkeses per dorezim, Pala Kontraktonjese, se ciles i eshte drejtuar kerkesa, duhet te marre menjihere masat per arrestimin e personit, qe kerkohet per dorezim.

Neni 63.

1/ Personi, qe duhet te arrestohet, mund te arrestohet edhe para marrjes se kerkeses per dorezim, kur arrestimi i tij kerkohet nga njera prej Paleve Kontraktonjese per shkak se ka vendim per arrestimin e ketij personi, ose vendim qe ka marre forme te prere, ose ndonje vendim tjeter perkates te gjykates, me kusht qe te jete bere lajmerimi se kerkesa per dorezim do te paraqitet.

Kerkesa per arrestim mund te dergohet nga organet kompetente me ane te postes, telegrafit, telefonit ose te radios.

2/ Personi mund te arrestohet edhe pa marjen e kerkeses se parashikuar ne pikën 1 kur ekzistojne prova te mjaftueshme se ay ka kryer ne territorin e Pales tjeter Kontraktonjese krimin qe shkakton dorezimin.

3/ Ne rastet e arrestimeve te parashikuara ne pikat 1 dhe 2, duhet te njoftohet me njeherë Pala tjeter Kontraktonjese.

. / .

Neni 64.

1/ Personi i arrestuar ne perputhje me piken 1 te nenit 63, mund te lirohet ne qofte se brenda nje muaji nga dita e nisjes se lajmerimit per arrestimin nuk do te paraqitet kerkesa per dorezim.

2/ Personi i arrestuar ne perputhje me piken 2 neni 63 mund te lirohet ne qofte se brenda nje muaji nga dita e nisjes se lajmerimit per arrestimin nuk do te paraqitet kerkesa simbas pikes 1 te nenit 63. Ky person mund te lirohet gjithashtu ne qofte se gjate muajit te ardheshem nuk do te paraqitet kerkesa per dorezim.

Neni 65.

Shtytja e dorezimit

Kur personi, qe kerkohet per dorezim, eshte marre ne per-gjegjesi penale, ose eshte denuar per kryerjen e nje krimi tjeter, dorezimi i tij mund te shtyhet gjer ne pushimin e çeshtjes, ose gjersa te kete vuajtur denimin ose gjersa te lirohet para kohe nga vuajtja e denimit.

Neni 66.

Dorezimi i perkohshem

1/ Ne rastet e parashikuara ne nenin 65, me kerkesa, mund te behet dorezimi perkohesisht ne qofte se shtytja e dorezimit do te shkaktonte kalimin e afatit te parashkrimit ose do t'i shkaktonte dem te madh hetimit te çeshtjes penale.

2/ Me perfundimin e procedimit penal, per periudhen e vazhdimit te te cilit ishte bere dorezimi, personi i dorezuar do te kthehet perseri.

Neni 67.

Paraqitja e shume kerkesave
per dorezim

Kur kerkesat per dorezim behen nga disa shtete, Pala kon-traktonjese, se ciles i drejtohen keto kerkesa, vendos se cila nga keto duhet te pranohet.

Neni 68.

Kufite e ndjekjes penale kundra personit te dorezuar

1/ Pa pelqimin e Pales Kontraktonjese, se ciles i eshte drejtuar kerkesa, personi i dorezuar nuk mund te meret ne pergjegje-si penale, te denohet ose ti dorezohet nje shteti te trete, per nje krim te kryer para dorezimit, per te cilin ay nuk u prezua.

2/ Nuk kerkohet pelqimi i permendur ne piken 1 ne qofte se personi i dorezuar, mbas pushimit te çeshtjes penale dhe, ne rast denimi, pas vuajtjes se denimit, ose pas perjashtimit nga vuajtja e denimit, brenda nje muaji nuk largohet nga territori i Pales Kontraktonjese, qe ka paraqitur kerkesen, ose kthehet perseri. Ne kete afat nuk llogaritet koha, gjate se ciles personi, jo per faj te tij, nuk ka mundur te largohet nga territori i Pales Kontraktonje se qe ka paraqitur kerkesen.

Neni 69.

D o r e z i m i

Pala Kontraktonjese, se ciles i eshte drejtuar kerkesa, detyrohet ta njoftoje Palen Kontraktonjese, qe ka paraqitur kerkesen per vendin dhe kohen e dorezimit. Ne qofte se Pala Kontraktonjese, qe ka paraqitur kerkesen nuk e mer ne dorezim personin e kerkuar brenda nje muaji pas dates se caktuar per dorezim, ky person mund te lirohet nga arrestimi.

Neni 70.

Dorezimi rishtas

Ne qofte se personi i dorezuar u shmanget ndjekjeve penale dhe kthehet ne territorin e Pales Kontraktonjese, se ciles i eshte drejtuar kerkesa atehere me kerkese, ai duhet te arrestohet dhe te dorezohet pa u paraqitur dokumentat qe permenden ne nenet 50 dhe 61.

Neni 71.

Njoftimi i perfundimit te ndjekjes penale

Pala Kontraktonjese qe ka paraqitur kerkesen duhet te njoftoje Palen Kontraktonjese se ciles i eshte drejtuar kerkesa mbi perfundimin e ndjekjes penale kunder personit te dorezuar. Ne qofte se per çeshtjen eshte dhene vendim dhe ky ka marre forme te pre-re, duhet te dergohet kopja e tij. Kjo vlen edhe per rastet e para-shikuara ne nenin 68.

Neni 72.

Kalimi tranzit i personave qe kane kryer krim

1/ Secila nga Palet Kontraktonjese, me kerkesen e Pales tjeter Kontraktonjese, duhet te lejoje kalimin ne territorin e saj te personave qe i dorezohen Pales tjeter Kontraktonjese nga nje shtet i trete.

Palet Kontraktonjese nuk jane te detyruara te lejojne kalimin ne qofte se dispozitat e kesaj Konvente nuk parashikojne dorezimin.

2/ Kerkesa, simbas pikes 1, perpilohet dhe paraqitet po n'ate menyre sidhe kerkesa per dorezim.

Neni 73.

Refuzimi i ndihmes juridike

Ndihma juridike per çeshtjet penale nuk jepet, perveç rasteve te permendura ne nenin 14, edhe :

a) kur ndihma juridike kerkohet per veprimtari, e cila nuk denohet penalisht nga legjislacioni i Pales Kontraktonjese, se ciles i eshte drejtuar kerkesa;

b) kur ndihma juridike kerkohet per krime qe nuk shkaktojne dorezimin.

Neni 74.

Dorezimi i personave te arestuar perkohesisht

1/ Kur lind nevoja per te pyetur si deshmitare persona qe mbahen te arestuar ne territorin e Pales Kontraktonjese, se ciles i eshte drejtuar kerkesa, organet e Pales Kontraktonjese qe permenden ne nenin 59 mund te urdherojne sjelljen e tyre ne territorin e Pales Kontraktonjese, qe ka bere kerkesen, me kusht qe ata te mbahen te arestuar dhe te kthehen menjehere pas mbarimit te marjes ne pyetje.

2/ Kur personat qe mbahen te arestuar ne nje shtet te trete thirren si deshmitare per tu mare ne pyetje nga organet e shtetit, i cili ka paraqitur kerkesen, organet e Pales Kontraktonjese qe permenden ne nenin 59, se ciles i eshte drejtuar kerkesa, lejojne kalimin e tyre nepermjet territorit te shtetit te tyre, duke respektuar dispozitat e parashikuara ne nenin 7.

Dorezimi i sendeve

1/ Palet Kontraktonjese, me kerkesen e tyre, i dorezojne njera tjetres :

- a) sendet qe jane fituar nga kryerja e nje krimi qe shkak dorezimin;
- b) sendet qe kane lidhje me krimin, qe shkakton dorezimin
- c) sendet te cilat mund te kene rrrendesine e provave materiale ne çeshtjen penale, edhe sikur dorezimi i personit qe ka krye krim nuk mund te behet per shkak te vdekjes se tij, aratisjes ose shkaqe te tjera.

2/ Ne qofte se sendet, qe kerkohen per dorezim, jane te ne vojeshme si prova materiale per çeshtjen penale per gjykaten ose prkurorine e Pales Kontraktonjese, se ciles i eshte drejtuar kerkesa, rezimi i tyre mund te shtyhet gjer ne perfundimin e çeshtjes.

3/ Te drejtat e personave te trete mbi sendet qe duhen dorzuar, mbeten te pa prekura. Pas perfundimit te çeshtjes keto sende duhet t'i kthehen Pales Kontraktonjese, se ciles i eshte drejtuar kkesa, per tia dorezuar personit qe kane te drejte mbi to.

Njoftimi mbi vendimet penale

1/ Palet Kontraktonjese do ti dergojne çdo vit njera tjetre njoftime mbi vendimet qe kane marre forme te prere, te dhena nga gjitat e njeres nga Palet Kontraktonjese kundrejt shtetasve te Pales ter Kontraktonjese, duke mare njikohesisht masat per te derguar shenjat e gishtave te te denuarve qe disponohen.

2/ Palet Kontraktonjese do ti dergojne me kerkeset njera tjetres njoftime mbi denimet e personave qe me pare banonin ne territor e Pales Kontraktonjese, se ciles i eshte drejtuar kerkesa, ne qofte keta persona do te meren ne pergjegjesi penale ne territorin e Pales Kontraktonjese, qe ka paraqitur kerkesen.

KAPITULLI III
DISPOZITA TE FUNDIT

Kjo Konvente duhet te ratifikohet. Shkembimi i instrumenteve te ratifikimit do te behet ne kohen me t'aferte ne ...Tiranë....

Neni 78.

Kjo Konvente do te hyje ne fuqi nje muaj pas shkembimit te instrumenteve te ratifikimit dhe do te jete ne veprim gjate 5 vjetave nga dita e hyrjes se saj ne fuqi.

Neqofte se brenda gjashte muajve para mbarimit te afatit te saj asnjera nga Palet nuk do te denoncoje kete Konvente, kjo mbetet ne fuqi çdo here edhe per pese vjete te tjera.

Kjo Konvente u perpilua ne dy kopje origjinale, secila ne gjuhen shqipe dhe gjermane dhe te dy tekstet kane fuqi te njejte.

Per vertetim sa me siper, te plotfugishmit e te dy Paleve Kontraktonjese neneshkruan kete Konvente dhe vune vulat e tyre.

Bere ne *Berlin me 11.1.1959*

ME AUTORIZIM TE
PRESIDIUMIT TE KUVENDIT
POPULLOR TE REPUBLIKES
POPULLORE TE SHQIPERISE

ME AUTORIZIM TE
PRESIDENTIT TE REPUBLIKES
DEMOKRATIKE GJERMANE

Ota Stinger

Bekir Hoxha

H. Hoxha

A.

